



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 19
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 27 qershor 2018, në orën 09:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Time Kadrijaj, Bekim Haxhiu, Fikrim Damka dhe Drita Millaku.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardianë Hasani- KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportimi i grupeve punuese për Projektligjet në procedurë;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Raportimi i grupeve punuese për Projektligjet në procedurë

Kryetarja tha se sot kemi pritur ta kemi në komision ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por ministri tani dy javë radhazi është jashtë vendit, edhe në javën e kaluar ishim jashtë vendit kështu që presim që ministri do të na përgjigjet pozitivisht mbledhjen e radhës.

Sa i përket raportimit të grupeve punuese, komisioni në këtë sesion ka në shqyrtim dy projektligjet, Projektligjin për gjak dhe produkte të gjakut dhe Projektligjin për ndërmarrje sociale.

Për Projektligjin për gjak dhe produkte të gjakut ia kaloi fjalën kryesueses së grupit punues, deputetes Fatmire Kollçaku.

Fatmire Mulhaxha – Kollçaku tha se si grup punues e kemi përfunduar punën dhe gjatë punës sonë kemi bashkëpunuar me QKKTGJ, dhe me Ministrinë e Shëndetësisë. Tani kemi një kërkesë nga Ministria e Shëndetësisë që ta ndryshojmë një amendament që ka të bëjë me inspektorin, i cili parashihet të jetë specialist i transfuziologjisë, por pasi nuk ka kuadro të mjaftueshëm ministria kërkon që inspektori mund të funksionojë vetëm me mjek pa specializim, pra ne ta tërheqim nga amendamenti fshirjen e fjalës, „mjek” dhe të mbetet si ka qenë në Projektligj.

Kryetarja tha se ky ligj ka kaluar te gjitha komisionet, dhe tani ne do ta përcjellim për seancë, por vetëm atë fjalë nga amendamenti mund ta tërheqim.

Time Kadrijaj tha se edhe gjatë punës se grupit punues e kam kundërshtuar këtë amendament duke i ditur vështirësitë me te cilat ballafaqohet inspektorati shëndetësor. Pajtohem që të jetë ashtu si parashihet me projektligj.

Kryetarja: Kalojmë te projektligji tjetër, Projektligji për Ndërmarrjet sociale. Grupin punues për këtë Projektligj e ka udhëhequr deputetja Flora Brovina. Grupi punues ka punuar gjatë në këtë projektligj dhe ka pasur dilemat e veta në disa nene. Kemi mbajtur dëgjim publik me palët e interesit, kemi pasur bashkëpunim edhe me ministrinë dhe kemi realizuar edhe një vizitë në Shqipëri me mbështetjen e OJQ „X”, ku kemi takuar me komisionin homolog, por edhe me disa aktorë kompetent për ndërmarrjet sociale. Kemi vizituar edhe disa ndërmarrje sociale të suksesshme në Shqipëri. Interesimi jonë ka qenë që ta vizitojmë Italinë, por pasi nuk mundem ta realizojmë, mendoj se edhe vizita në Shqipëri ishte e suksesshme. Gjatë vizitës e pamë që edhe Shqipëria ka vështirësi në zbatimin e Ligjit për ndërmarrje sociale. Pas kthimit nga vizita kemi punuar ne grup punues dhe besoj që në mbledhjen e ardhshme do t’i votojmë amendamentet. Për këtë Projektligj kemi pasur edhe një ekspertizë nga një ekspert Slloven, e angazhuar nga zyra e BE në Kosovë.

Haxhi Avdyli: Ky ligj është shumë i rëndësishëm sepse i përkrah të rinjtë dhe grupet e marginalizuara. Ndërmarrjet sociale janë ndërmarrje në mes OJQ –ve dhe bizneseve dhe ku ndahen ne dy grupe, grupi A që afron shërbime për grupet e marginalizuara dhe grupi B i cili zhvillon biznes, por e ka kusht të punësoi 30% nga grupet e cenueshme. Përvoja e Shqipërisë është përvojë që nuk duhet marrë shembull sepse ata kanë miratuar ligjin tani dy vite, por nuk kanë mundur ta zbatojnë, sepse nuk kanë nxjerrë aktet nënligjore. Ne duhet të punojmë, ta bëjmë një ligj të zbatueshëm, por duhet të kërkojmë edhe përkrahje financiare për zbatim të këtij ligji. Pa një përkrahje institucionale, as ky ligj nuk do t’i japë rezultatet e pritura.

Flora Brovina: Ky ligj ka pasur probleme, por nga ekspertja sllovene kuptuam që edhe këto ndërmarrje mund të jenë të suksesshme. Kjo përvojë e ndërmarrjeve sociale ka ekzistuar tani sa kohë në Kosovë sepse ne kemi shumë gra që me punën e tyre artizanale mbajnë familjet e tyre, por kjo nuk ka qenë e rregulluar me ligj. Tani presim që me miratimin e Ligjit, Qeveria dhe komunitat t’i përkrahin këto ndërmarrje sociale dhe ato të funksionojnë si të regjistruara. Ka edhe disa fonde të BE- së që jepen për këto ndërmarrje sociale dhe pas miratimit të ligjit, të kanë mundësi ndërmarrjet sociale të konkurrojnë edhe për këto fonde.

Ligji jonë është më i favorshëm se ligji i Shqipërisë dhe presim të ketë sukses. Ky Ligj lidhet edhe me Rezolutën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

3. Të ndryshme

Kryetarja: Fillimisht përshëndes anëtarin e re të komisionit, znj. Drita Millaku, i uroj punë të mbarë në këtë komision.

Sa i përket raportimit të ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale në komision, ju informoj se ministri ndodhet jashtë Kosovës dhe nuk ka mundur të marrë pjesë në Komision, por do ta ftoj në mbledhjen e radhës. Ne kemi shumë kërkesa për ministrin dhe do t'i adresojmë në takim me ministrin. Po ashtu mendoj që në komision do ta ftojmë në raportim edhe ministrin e Shëndetësisë dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.

Time Kadrijaja: Mendoj se është shumë e rëndësishme që t'i kemi në komision të raportojnë dy ministrat dhe Oda e Profesionistëve Shëndetësorë, prandaj t'i ftojmë dhe ai që mund t'i përgjigjet pozitivisht ftesës, ta kemi në Komision.

Naser Rugova: Mendoj që përveç raportimit të ministrave, ne të realizojmë edhe vizita në spitalet e përgjithshme për shkak të një diskrepance të madhe në afrimin cilësor të shërbimeve.

Gjithashtu ka mungesë të barnave esenciale dhe të domosdoshme. Ne mund të bëjmë ligje, por nëse nuk kemi shërbime cilësore dhe nuk kemi furnizim me barna atëherë është i kot miratimi i ligjeve. Duhet t'i ngrehim këto shqetësime në mënyrë institucionale dhe t'i vizitojmë të gjitha spitalet rajonale. Statuti i SHSKUK duhet të ndryshohet në mënyrë urgjente, nuk mundet drejtori i SHSKUK t'i menaxhoj klinikat e QKUK e të mos flasim për menaxhimin e spitaleve të përgjithshme.

Funksionimi i sistemit shëndetësor në Kosovë matet me funksionimin e QKUK, e ky nuk është fare funksional.

Haxhi Avdyli: Mendoj që gjendja e furnizimit me barna në spitale është alarmante dhe puna e mjekëve është duke dështuar. Edhe ne e kemi bërë një plan të punës, sa e kemi përmbushur atë plan. Në agjendën legjislativë kanë qenë të parapara të vinë Ligji për shëndetësi dhe Ligji i sigurimeve shëndetësore, por nuk kanë ardhur.

Përveç ministrit mendoj që në komision t'i ftojmë edhe kryesuesin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe të na raportojnë për punën dhe planet e tyre, dhe për funksionalizim të fondit të sigurimeve shëndetësore.

Flora Brovina: Në mandatin e kaluar kemi monitoruar Ligjin për shëndetësi, kemi vizituar të gjitha spitalet, dhe jemi të njohur me problemet e tyre, por fatkeqësisht nuk arritëm ta miratojmë raportin në komision. Po presim të vije ndryshimi i Ligjit për shëndetësi dhe aty t'i adresojmë mangësitë. Edhe statutit i SHSKUK nuk mund të ndryshohet pa u ndryshuar Ligji i Shëndetësisë. Edhe nga tryeza e organizuar për përdorimin e drogave nga të ritë, u pa se shumë institucione kanë nevojë për fuqizim me Ligj të Shëndetësisë.

Ministrin dhe Odat e mjekëve duhet t'i ftojmë dhe të diskutojmë për shumë probleme që janë evidente në shëndetësi e që ne i kemi vërejtur edhe gjatë monitorimit të Ligjit të Shëndetësisë.

Fatmire Kollçaku-Mulhaxha: Kam menduar që vizitat në spitale do t'i bëjmë gjatë amendamentimit të ligjit, por pasi ligji nuk po vjen për ndryshim do jetë mirë që spitalet rajonale t'i vizitojmë gjatë shtatorit.

SHSKUK është një strukturë e dështuar dhe patjetër duhet ndryshuar, gjithmonë ka qenë tendenca e decentralizimit, por në realitet ka ndodh centralizimi. Ka shumë shqetësime nga pacientët për

furnizimin me barna e sidomos në institutin e onkologjisë. Ky institut është funksional dhe po punon mirë, por furnizimi me barna po ua vështirëson punën.

Problemi numër një në Kosovë sot janë sëmundjet malinje, dhe ne duhet ta mbështesim Institutin Onkologjik dhe në listën esenciale të barnave duhet të përfshihen barnat e nevojshme për trajtimin e këtyre sëmundjeve.

Time Kadrijaj: Temat duhet të jen më të strukturuar dhe të diskutojmë rreth temave. Pastaj edhe te vizitat duhet të jemi më të përgjegjshëm dhe të marrim pjesë.

Flora Brovina: Gjatë monitorimit vitin e kaluar kemi hasur në disa probleme të cilat duhet t'i adresojmë.

Bekim Haxhiu: Pavarësisht subjekteve politike, brengat dhe problemet që po na i adresojnë qytetarët, do mundohemi me ju gjetur zgjidhje. Ministrat po ndërrohen, tani tri mandate, por asgjë nuk po bëhet në shëndetësi. Pakoja ligjore e Ligjeve të Shëndetësisë është miratuar në mandatin e ministrit Agani, pako e cila ka mundur ta vë në binar sistemin shëndetësor, por pa implementimin e sigurimeve shëndetësore është e kotë, nuk ka shëndetësi cilësore.

Krijimin e SHSKUK dhe shuarjen e QKUK e kam kundërshtuar edhe në mandatin e kaluar, po ashtu e kam kundërshtuar edhe bartjen e fondit për blerjen e barnave nga SHSKUK, te Ministria e Shëndetësisë. E kam ditur që furnizimi me barna nuk do jetë më i mirë, vetëm ka me u rrit kostoja e blerjes së barnave. Me rritjen e buxhetit vetëm po rritet kostoja e barnave e nuk po kemi furnizim më të mirë. Shikoni sa i ka kushtuar buxhetit të shtetit vetëm blerja e insulinës, nga dhjetori e deri tani rreth 7 milionë e gjysmë euro.

Gjithashtu nuk ka fare qasje për integrimin e spitaleve që funksionojnë jashtë sistemit shëndetësor të Kosovës. Duhet të ju bëhet e qartë qytetarëve që janë jashtë sistemit shëndetësor të Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në pjesët tjera të Kosovës, se nëse mbesin jashtë sistemit të sigurimeve shëndetësore do t'ju dëmtohet shëndeti dhe buxheti i tyre, sepse me funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore nuk ka kush paguan për ta dhe do të duhet të paguajnë nga xhepi i tyre. Para se të vije në komision, ministri i Shëndetësisë duhet patjetër ta ftojë ministrin e Punës dhe të diskutojmë për problemin e pensionistëve, dhe patjetër duhet ta heqim nenin diskriminues që ju ndalon njerëzve të marrin pensionet pa i përmbushur 15 vjet përvojë pune. Ne i kemi pasur në komision ish- policët dhe të tjerët që në atë kohë kanë bërë një veprim patriotik dhe e kanë lënë punën në polici, tani nuk mund ti marrin pensionet, ndërsa ata që kanë vazhduar punën me sistemin e atëhershëm, tani i marrin pensionet, ndërsa ata të larguarit nga puna janë të dëmtuar edhe në aspektin material edhe në aspektin moral, prandaj atë nenë diskriminues duhet ndryshuar me procedurë të shpejtë.

Ministrin e Shëndetësisë mendoj se duhet ta takojmë bashkë me odat e profesionistëve shëndetësorë, sepse ata kanë disa kërkesa, e ministri fare nuk i takon. Pastaj te Projektligji i pagave kam vërejtur se 50% e kategorive në mjekësi, janë harruar, nuk ishin përfshirë fare në projektligj.

Mungesa e furnizimit me barna është shqetësuese, ndërsa revidimi i listës esenciale ka mund me zgjat më së shumti një muaj.

Sa i përket problemit të spitaleve rajonale, ndoshta do jetë më mirë t'i ftojë këtu dhe të zhvillojmë debat për problemet me të cilat ballafaqohen. Gjithashtu mendoj që nëse tentohet të implementohen sigurimet shëndetësore pa u implimentuar SISH, atëherë sigurimet bëhen për me manipuluar, e jo për t'i zgjedh problemet.

Drita Millaku: Përshëndes anëtarët e komisionit dhe besoj do ta kemi një bashkëpunim të mirë.

Të gjithë jemi këtu t'i adresojmë kërkesat dhe problemet e qytetarëve, duke e ditur se sektori i shëndetësisë ka shumë probleme. Edhe pse shpesh problemet janë adresuar nga ky komision, gjërat në tërësi nuk po ecin si duhet. Është punuar shumë në miratimin e ligjeve, por këto ligje duhet të monitorohen, a po zbatohen. Çdo ditë e më shumë kemi mungesë të medikamenteve të cilat janë shumë të kushtueshme dhe vështirë po përballohen nga qytetarët.

Pajtohem me kolegun që sigurimet shëndetësore janë kushti i domosdoshëm për një shëndetësi të qëndrueshme dhe do të kemi më pak probleme në shëndetësi.

Dëshiroj ta kem edhe planin e punës dhe të jem e njoftuar me punën në vazhdim që do të bëjmë në komision.

Bekim Haxhiu: Edhe në mandatet e kaluara, bashkërisht si komision kemi punuar që disa projekte të ecin përpara, ndërsa disa projekte që i kemi iniciuar si komision, tani ky ministër po i përuron, por ne, si deputetë nuk jemi fare të ftuar. Nëse ministri i Shëndetësisë mendon me realizuar projekte pa bashkëpunim me këtë komision, nuk do ketë suksese.

Enver Hoti: Përveç punës në komision, edhe në Parlament, edhe në vende të tjera, duhet ta ruajmë kompaktësinë e komisionit, dhe t'i mbrojmë parimet e komisionit. Çelësi i problemeve në shëndetësi është te sistemi i drejtësisë. Ne kemi raportet e auditimit dhe i dimë ku janë defektet, por nuk po vepron sistemi i drejtësisë. Kemi të bëjmë me keqpërdorime të cilat po na i tregon raporti i auditimit, por nuk po ka masa dhe veprim të organeve të drejtësisë.

Nuk pajtohem që ministrin ta ftojme bashkë me institucione e tjera. Mendoj ta ftojme ministrin sepse ai na raporton, e ai t'i marrë në mbledhje kënd të dëshirojë.

Kryetarja komisioni ka miratuar planin e punës dhe është brenda kornizave të atij plani. Sa i përket monitorimit të ligjeve, ky komision ka më së shumti monitorime të ligjeve.

Plani i punës së komisionit hartohet sipas strategjisë legjislative të ligjeve të Qeverisë dhe tani në sesionin vjeshtor do ta ndryshojmë planin dhe ta përshtatim me strategjinë e Qeverisë.

Për javën që vjen, do të ftojme për të raportuar në komision ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ministrin e Shëndetësisë për të raportuar.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU